

VENDIM
Nr. 117, datë 13.2.2020

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS, PËR VITIN 2020

(Ndryshuar me VKM nr. 575, datë 22.7.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit buxhetor të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2020, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2020, sipas shtojcave nr. 2 e nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2020.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

(ndryshuar me VKM nr. 575, datë 22.7.2020)

SHTOJCË NR. 1
PEMA E PROGRAMIT TË ASHK-së PËR VITIN 2020

Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepërmjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditësimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme si dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. ASHK ka për mision të zbatojë politikat sektoriale në fushën e legalizimit të ndërtimeve pa leje, rregullimit të raporteve të pronësisë mbi truallin dhe zhvillimit urban të territoreve me ndërtime të legalizuara. ASHK, do të vazhdojë të kryejë detyrat dhe të ushtrojë përgjegjësitë e përcaktuara në përputhje me Ligjin Nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, dhe Ligjin Nr.10186, datë 05.11.2009 "Për rregullimin e pronësisë në truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. ASHK ka për qëllim gjithashtu të kryejë inventarizimin e plote të pronave shtetërore

OBJEKTIVAT

OBJEKTIVI 1: Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme dhe Përmirësim Përditësimi i të dhënave

OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

OBJEKTIVI 3: Rindërtimi i infrastruktures së ASHK, rikonstruksion ndertesash, kompletimit të Drejtorive të ASHK-së me pajisje dhe orëndi të domosdoshme

OBJEKTIVI 4: Legalizimi i Ndërtimeve Informale

OBJEKTIVI 5: Inventarizimi i Pronave shtetërore

```
graph TD
    A["OBJEKTIVI 1: Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme dhe Përmirësim Përditësimi i të dhënave"]
    B["OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;"]
    C["OBJEKTIVI 3: Rindërtimi i infrastruktures së ASHK, rikonstruksion ndertesash, kompletimit të Drejtorive të ASHK-së me pajisje dhe orëndi të domosdoshme"]
    D["OBJEKTIVI 4: Legalizimi i Ndërtimeve Informale"]
    E["OBJEKTIVI 5: Inventarizimi i Pronave shtetërore"]

    A --- B
    A --- C
    A --- D
    A --- E

    B --- B1["Projekt: Përmirësim/Përditësimi i të dhënave të Pasurive të Paluajtshme dhe Regjistrimi Fillestar nrm ZRPP"]
    B --- B2["Automatizim i sistemit të regjistrimit të pasurive"]
    B --- B3["Rindërtimi i infrastruktures së ASHK-së"]

    B1 --- B1_1["Prod. 1: Përmirësim dhe përditësimi i të dhënave dhe Regjistrimi Fillestar i Pasurive të Paluajtshme"]
    B2 --- B2_1["- Përmirësimi i Arkivës Dixhitale -Mirembajtja e sistemeve elektronike"]
    B3 --- B3_1["Prod 1: Rikonstrukcion i objekteve ndërtimore të rezultuara të pabanueshme nga termoti"]
    B3 --- B3_2["Prod 2: Rikonstrukcion i ndertesave të ASHK-së transferu me VKM dhe ekzistuese"]
    B3 --- B3_3["Prod. 3: orëndi dhe pajisje të domosdoshme për kryerjen e shërbimeve"]
```

SHTOJCË NR. 2

Në 000/ lekë

PËRSHKRIMI	Buxheti janar–dhjetor 2020	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	4,053,756	
Shpenzime personeli		1,793,561
Shpenzime korente		580,000
Investime		1,018,051
Fonde të parashikuara për t'i transferuar ATP-së gjatë vitit		468,732
Fondi rezervë		104,700
Fonde të pashpërndara të parashikuara për t'u trashëguar në vitin e ardhshëm		88,712
Totali	4,053,756	4,053,756
Teprica (1)-(2)		0

SHTOJCË NR. 3

BUXHETI I ASHK-së JANAR–DHJETOR 2020

Në 000/ lekë

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI JANAR–DHJETOR 2020/ I RISHIKUAR
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	4,053,756
1	Të ardhura nga shërbimet	1,459,990
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	665,576
3	Të ardhura të tjera	89,447
4	Fonde që trashëgohen nga viti 2019	1,838,743
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	4,053,756
1	Shpenzime personeli	1,793,561
	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të miratuar	948,609
	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit në organikë	157,236
	Paga për punonjësit me kontratë (690)	548,660
	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë	91,626
	Fondi i veçantë i pagave	47,430
2	Shpenzime operative	580,000
	Shpenzime për mallra dhe shërbime	430,000
	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	150,000
3	Shpenzime kapitale	1,018,051
	Investime kapitale të patrupëzuara	410,761
	Drejtoria e projektit të përmirësimit përditësimit (300)	303,000
	Shpenzime për investime tjera të patrupëzuara	107,761
	Investime kapitale të trupëzuara	607,290
4	Trasferim në fondin special të ATP-së	468,732
5	Fondi rezervë	104,700
	Fondi rezervë	104,700
6	Fonde të pashpërndara	88,712
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	0

